

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL  
NGA MBLEDHJA E -VII-të E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË,  
MBAJTUR MË 30 KORRIK 2015**

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën **10:10**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Hysni Gërguri, Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Syzana Sylja, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe nënkryetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** –propozoi dy pika shtesë të rendit të ditës në pikën në të ndryshme.

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit**–në emër të grupit kuvendar të PDK-së propozoi që pika 2 të hiqet nga rendi i ditës, për shkak se në Komitetin për Politikë dhe Financa, është kërkuar që të ofrohet raporti për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore në baza tre mujore, dhe në këtë drejtim nuk është bërë asnjë ndryshim ku i njëjti raport është edhe tani i ofruar para anëtarëve të kuvendit. Andaj në fund ai vlerësoi se një raport i tillë në hartuar në baza gjatë mujore nuk është në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit për menaxhimin e financave publike.

**Argon Përçuku, anëtar i kuvendit**–shprehu shqetësimin e tij lidhur me ngjarjet e fundit, nga aksidentet e komunikacionit, ku nga këto aksidente humben jetën disa qytetarë të Komunës së Vushtrrisë. Tutje ai shprehu keqardhjen e tij për vdekjen e Krenarë Nezirit në një aksident komunikacioni i cili ishte një anëtar i devotshëm i LDK-së. Në fund ai kërkoi nga strukturat komunale dhe policia që të shtojnë masat për parandalimin e aksidenteve në komunikacionin, në të njëjtën kohë ai kërkoi nga kuvendi që të mbahet një minutë heshtje për të gjitha viktimat që humben jetën nga aksidentet e komunikacionit kohet e fundit në Komunën e Vushtrrisë.

**Fatime Haziri, anëtare e kuvendit** –shprehu reagimin e saj për siç tha ajo se pika e 11 e rendit të ditë rregullorja për menaxhimin e mbeturinave nuk ka kaluar në KPF, dhe për të njëjtën akoma nuk kemi një mendim profesional të zyrës ligjore të Komunës se kjo rregullore a është në pajtim me ligjin apo jo. Tutje ajo pyeti se përse që nga viti 2012 nuk është ndërmarrë as

edhe një veprim për menaxhimin adekuat të mbeturinave edhe pse ka ekzistuar ligji për një çështje të tillë. Pastaj ajo pyeti se a është menduar për fatin e rreth 50 punëtorëve të kompanisë “Uniteti” njësia në Vushtrri, dhe se me këta punëtor a është lidhur ndonjë kontratë që të njëjti të kalojnë në projektin e ri që ka komuna për menaxhimin e mbeturinave. Në fund ajo tha se në komisioni i cila ka punuar në hartimin rregullores për menaxhimin e mbeturinave ka qenë mirë të jenë të përfaqësuar të gjitha subjektet politike kuvendare në Kuvendin Komunal të Vushtrrisë.

**Abit Abiti**, ZKF-paraqiti sqarime dhe një arsyetim lidhur me raportin tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, si dhe realizimin e investimeve kapitale, duke cekur se kjo pikë duhet kaloj pasi për këtë është marr mendim profesional i zyrës ligjore.

*Pas debatit lidhur me rendin e ditës kuvendi, me një minutë heshtje i nderoj të gjitha viktimat të cilat pësuan nga aksidentet e komunikacionit në Komunës e Vushtrrisë gjatë ditëve të fundit.*

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me 21 vota “për” të tjerat “abstenim” aprovoi këtë:

## REND DITE

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
2. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare për vitin 2014.
3. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2016.
4. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2014/2015.
5. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë ushqimore.
6. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor i aktiviteteve Kulture, Rinore dhe Sportive.
7. Shqyrtimi Propozim-Vendimit për shpërndarjen e mjeteve nga Fondi për Transfere dhe Subvencione.
8. Shqyrtimi i Draft-Planit të veprimit për rini.
9. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për promovimin dhe fuqizimin e vullnetarizmit të të rinjve dhe pjesëmarrjen e rinisë.
10. Shqyrtimi i Draft-Planit pesëvjeçarë për menaxhimin e mbeturinave për periudhën 2016-2020 në Komunën e Vushtrrisë.
11. Shqyrtimi i petitionit të banorëve të fshatit Gllavatit lidhur me kundërshtimin e vendimit të KK-së 01 Nr.70/14 të datës 27.03.2014.
12. Shqyrtimi i petitionit të autokombajnerëve të Komunës së Vushtrrisë.
13. Të ndryshme.
14. a). Shqyrtimi i Draft-rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunës e Vushtrrisë.
14. b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për shërim për Xhavit Hysenin.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës Kuvendi me vota unanime aprovoi procesverbalin e mbledhjes paraprake të KK-së.*

2. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare për vitin 2014.

**Fatime Haziri, anëtare e kuvendit** –tha se kur i referohemi raportit të auditorit atëherë del se si është e mundur që raporti i auditorit të gjejë aq shumë vërejtje duke përfshirë aq shumë drejtori. Gjithnjë sipas këtij raporti evidentohet se sivjet kemi një regres të theksuar në

menaxhimin e financave publike te komunës, duke filluar nga hartimi i pasqyrave financiare qe kane marre opinion e auditimit ne një shkalle me te ulet se vitin e kaluar. Pastaj ajo vlerësoi se autoritetet komunale vazhdimisht mburreshin me opinionin e auditorëve për pasqyrat e pakualifikuara, kurse sivjet keni marre opinionin e kualifikuar. Mandej ajo bëri të ditur se prezantimi jo i drejte i pasqyrave financiare çfarë veprë është se në fund ato i nënshkruan kryetari i komunës andaj kush duhet të përgjigjet për këto gabime? Nga 14 rekomandimet e vitit te kaluar, ju vetëm 6 rekomandimeve ju keni adresuar plotësisht, 4 pjesërisht, kurse 4 rekomandimeve nuk ju keni adresuar fare. Nga raporti i auditimit shihet se komuna nuk i din mire pronat e veta, e edhe ato qe i menaxhon, nuk i menaxhon mire, sepse vetëm nga 4 mostra qe i ka marre auditori rezulton se 10.389€ nuk i ishin paguar komunës nga ata 4 shfrytëzues te pronës komunale e ku janë pronat tjera qe nuk dihet se si shfrytëzohen. Edhe te prokurimi janë dhënë vërejte serioze ku ne disa raste është shkelur ligji i prokurimit publik p.sh: Komuna kishte lidhur kontrate ne vlere 22.957€ me operatorin ekonomik te papërgjegjshëm për “ndërtimin me kubeza betoni te dy rrugëve lokale”, ku operatori ekonomik fitues nuk kishte ofruar dëshmitë e kërkuara ne dosjen e tenderit si: Kontratën e punës për 5 punëtorë, një inxhier te ndërtimtarisë me kontratë pune dhe pajisje te punës të kërkuara ne dosjen e tenderit. Një tjetër shkelje te prokurimi kemi ne tenderin për asfaltimin e 3 rrugëve lokale: te komuna e re, dhe një rrugë ne fshatin Stanovc dhe Samadrexhe. Nga raporti i auditimit shihet se procedurat e prokurimit ishin zhvilluar pa hartuar projektin ekzekutiv ashtu siç kërkohet me udhëzimin administrativ nr.1/2014 te lëshuar nga KRPP (Komisioni rregullativ i Prokurimit Publik) dhe aq me keq këtu janë bere ndryshime substanciale te pozicioneve te kontratës pa aprovimin te kuvendit komunal dhe kryetarit, por vetëm me pëlqimin e organit mbikëqyrës dhe menaxhimit të projektit. Rruga te objekti i ri i komunës 150m gjatësi është planifikuar te shtrohet 19cm e trashë, kurse është shtruar vetëm 12cm dhe disa rrugica tjera ne fshatin Stanovc me gjatësi 133m janë shtruar me vetëm 7cm trashësi asfalt dhe qe nuk kane qene te parapara me kontratën aktuale. Mund ta marrim me mend se çfarë asfalti mund te shtrohet me 7 cm trashësi, dhe ceku se kush do te përgjigjet për këto shkelje te ligjit te prokurimit publik dhe injorimit te Kuvendit Komunal dhe të kryetarit të komunës.

Vërejtje kemi edhe te donacionet ku komuna ka participuar në shume projekte pa u siguruar se projektet janë kryer ne tërësi dhe edhe nëse janë kryer ne tërësi nuk janë kompletuar lendet ne këto projekte.

Në fund ajo pyeti kryetarin e komunës se a do të merren masa ndaj të gjithë zyrtarëve përgjegjës të këtyre shkeljeve në menaxhimin e financave publike. **Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – lidhur me raportin e auditorit të përgjithshëm për pasqyrat financiare të komunës për vitin 2014 parashtroj disa pyetje: pse komuna nuk i ka prezantuar pagesat për palët e treta në vlerë prej 89.000 €?

Për çfarë projekti kapital në vlerë prej 94.193€ bëhet fjalë dhe pse Auditori nuk ishte në gjendje të marrë siguri për vlerën e parasë së shpenzuar?

Si ka mundësi të bëhet një pagesë prej 20.000 € për një projekt që nuk është implementuar dhe është regjistruar si shpenzim kapital?. Ku kanë shkuar këto 20.000 €?

Si është e mundur që komuna të kryej pagesa në llogari të donatorëve në shumën mbi 40.000 €, kurse donatorët nuk kanë ofruar asnjë dokument relevant si: faturë, raport të punës etj?

Neve na intereson ta dimë se kush janë këta donator të cilëve u është paguar kjo shumë parash?

Tek Të hyrat vetanake, faqe 17 pse komuna e Vushtrrisë nuk ka ndërmarrë masa veprimi ndaj shfrytëzuesve afatshkurtër të pronës komunale të cilët nuk i kanë kryer obligimet financiare

Pastaj tek Drejtoria e Prokurimit pyetja është pse kanë ndodhur shkelje të procedurave të prokurimit duke lidhur kontratë në vlerë 23.000 me Operatorë Ekonomik të papërgjegjshëm të cilët nuk kanë ofruar dëshmitë si: kontratat për 5 punëtorë, inxhinierin e ndërtimtarisë dhe pajisjet e punës. Gjithashtu, na intereson të dimë se: Kush janë këta Operatorë?

Mandej në faqe 22 si mund të ndodh që komuna gjatë vitit 2014 t'i regjistrojë si projekte finale projektet që janë në investim e sipër?

Si dhe në faqe 23 pse obligimet kontraktuale për paga dhe mëditje për arsimtarë nuk janë raportuar. Pse nuk mbahet evidencë për faturat e papaguara dhe pse nuk protokolohen ato?

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** –tha se vet fakti i mos aprovimit për futje në rend të ditës të raportit për të hyrat dhe shpenzimet, tregon se është në përputhje të plotë me raportin e auditorit i cili konstaton se pasqyrat financiare vjetore nuk i përmbushin kriteret e duhura raportuese për ti pasqyruara gjërat në mënyrë objektive. Tutje ceku se si kuvend asnjëherë nuk kanë marrë shënime lidhur me borxhet e këqija dhe anëtarët e kuvendi akoma nuk e dinë se sa është shuma e këtyre borxheve dhe cilët janë ata debitorë të cilët kanë shuma të mëdha të këtyre borxheve. Pastaj ai vlerësoi se askush nga autoritetet komunale qoftë kuvendi apo kryetari i komunës nuk kanë të drejt të bëjnë pagesa për punët e papërfunduara, mandej askush nuk ka të drejt të bëjë bartjen e mjeteve financiare prej një kategorie ekonomike në një tjetër gjë e cila është konstatuar në raport, se ka ndodhur dhe atë në shumen prej 65.500€ nga kategoria e investimeve kapitale në mallra dhe shërbime gjatë këtij viti. Tutje ndryshimi i pozicioneve të kontratës të konstatuara gjithnjë në raportin e auditorit, sikur që ka ndodhur nuk guxon që një ndryshim i tillë të bëhet nga menaxheri i kontratës (projektit) por se këto ndryshime duhet të bëhen konform procedurave ligjore. Në vazhdim ai vlerësoi se nëse në një projekt komuna ka participuar me vlerën me mbi 50% atëherë ligjërisht komuna duhet ti zhvilloj procedurat e prokurimit e jo ti jepet një donatori apo firme tjetër sikur që ka ndodhur në komunën tonë në dy raste ku janë nënshkruar kontratat dhe nuk dihet se ku janë investuar ato mjete, andaj në të gjitha këto çështje kërkoj që të dihet se ku kanë shkuar këto mjete. Një çështje tjetër të cilën e shtroj për diskutim dhe shqyrtim është njësia e auditorit të brendshëm e cila duhet të jetë më efikase në përcjelljen e gjendje së të hyrave dhe shpenzimeve në mënyrë të gjithmbarshme si dhe duke u kujdesur për të gjitha kodet dhe kategoritë ekonomike që lidhen me investimet kapitale të hyrat dhe shpenzimet e parasë publike në përgjithësi në komunën tonë. Në fund ai tha se kryetari i komunës dhe ekzekutivi në përgjithësi duhet të ketë një planë, i cili do ti adresonte dhe merrte për bazë të gjitha rekomandimet e auditorit të përgjithshëm në ngritjen e mirë menaxhimit të parasë publike.

### 3. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2016.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** –tha se sa i përket shqyrtimit të draft rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2016, edhe në seancën e datës 29 shtator të vitit 2014, kishte kërkuar që duke iu referuar draft rregullores në fjalë, bazuar në nenin 6.4 të Ligjit për kategoritë e dalura nga lufta lirohen nga pagesa e tatimit në pronë këto kategori:

- Familjet e dëshmorëve
- Invalidët e UÇK-së
- Invalidët civil të luftës
- Familjet e viktimave civile të luftës që janë në gjendje të rëndë ekonomike.

Gjithashtu kishte propozuar që paragrafi në fjalë të përfshihet në draft rregullore, gjë që nuk kishte ndodhur.

Drejtori asokohe pati thënë që kjo gjë nuk mund të bëhet dhe se do konsultohet me Ministrinë për këtë çështje, dhe brenda një kohë të shkurtë do të na njoftojë më gjerësisht. Ky njoftim fatkeqësisht nuk ka ndodhur kurrë.

Ne, prapë në këtë seancë kërkojmë që ky nen të inkorporohet në këtë draft rregullore dhe këto kategori të lirohen nga pagesa e tatimit në pronë, sepse është e drejtë e tyre, e garantuar me Ligj. Po ashtu, ia bëjmë me dije drejtorit që shumë komuna e kanë futur këtë nen në draft rregulloret e tyre, ndër to edhe komuna e Skenderajt.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** –në emër të grupit kuvendar të LDK-së, kërkoi që në draft-rregulloren e tatimit në pronë të futet një nen ku do të liroheshin nga ky obligim të gjitha kategoritë e dal nga lufta si dhe familjet me asistencë sociale. Tutje shtoi se akoma nuk kemi asgjë konkrete në drejtim të ndarjes së qytetit në nën zona tatimore dhe ceku se edhe pesë zonat

që janë aktualisht të ndara nuk janë të rregulluara mirë si dhe nuk janë duke u respektuar kriteret e mirëfillta. Pastaj ai paraqiti një shembull ku zona e parë e cila fillon nga “Kosova Petroli” dhe vazhdon deri tek “Ura e Hekurit” në të cilën bëjnë pjesë edhe disa rrugë, në këtë zonë mund të thuhet se prona nuk e ka vlerën e njëjtë as të qiras dhe as të shitjes dhe kjo vlen si për pronat rezidenciale ashtu edhe ato biznesore ku vlera nuk është e njëjtë si në qendër të qytetit, krahasuar me periferinë e qytetit, dhe për këtë kërkoj që bëhet ndarja në nën zona.

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-** paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** –tha se drejtorja, e ka kryer obligimin ligjor që ka për hartimin e kësaj rregulloreje për çdo vit vijues, mirëpo kur bëhet fjalë për ndarjen e territorit të komunës në zona tatimore atëherë nuk po i dimë akoma se cilat kritere po merren për bazë për ndarjen e këtyre zonave, dhe ceku se nëse në një zonë është e rregulluar mirë infrastruktura (rrugët, trotualet, kanalizimi, ndriçimi, dhe rryma kualitative), atëherë sigurisht se kjo zonë duhet të ketë koeficient më të lartë të tatimit në pronë. Pastaj ai aksentoi se lokalitetit prej vendit të quajtur “ura e hekurit” deri tek maxhistrallja është një pjesë mjaft e urbanizuar e qyteti dhe për këtë kërkoi që bëhen ndryshime. Në fund ai kërkoi që për këtë rregullore të kemi një debat më gjithëpërfshirës në kuptimin e hartimit të një rregulloreje sa më të mirë.

**Zoran Rakiç, anëtar i kuvendit-pyeti** se përse fshati Banjësk është futur në zonën e dytë tatimore, kur dihet fakti se ky fshatë nuk ka ndonjë infrastrukturë të rregulluar mirë, andaj kërkoi që ky fshatë të futet në zonën e tret apo të katërt ngjashëm sikurse fshatrat Prelluzh, Lumadh, dhe Mavriq.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

**1.Jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Tatimin e Pronës së Paluajtshme për vitin 2016**

**2.Diskutimi publik fillon nga data 05 gusht 2015 dhe zgjatë deri më 19 gusht 2015.**

**3.Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.**

**4.Obligohet Drejtorja për Buxhet dhe Financa që si hartues dhe propozues i Draft-Rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 05/2013, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.**

**Gjithashtu DBF-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t’ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin shtator 2015.**

**4. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2014/2015.**

**Qerim Selimi, anëtar i kuvendit**–tha se informata në fjalë e ka përshkruar në detale punën e Drejtorisë së Arsimit. Tutje ai u ndal veçanërisht në suksesin e testit të maturës që këtë vite ka pasur shumë ndryshime për dy arsye dhe atë duke ju referuar thirrjes së tij si anëtar i Komisionit Shtetërorë të Maturës, ku në këtë kontekst vlerësoi se rezultatet e këtij testi mund të thuhet se janë përafërsisht reale, duke e ditur se në çfarë mënyre sot përdoret teknologjia (duke marr për bazë formën e përdorimit të telefonit). Gjithashtu ai njoftoi kuvendin se në afatin e

gushtit do të ketë ndryshime sa i përket testit të maturës si dhe në këtë afat do të ketë sanksione edhe me të ashpra se sa në afatin e kaluar. Pastaj ai ceku se në bazë të kësaj informate del konstatime se për çdo vit kemi ngritje të rezultateve, mirëpo apeloj të mësimdhënësit por edhe tek të gjithë stafi dhe personeli arsimor që të kemi një angazhim të përgjithshme si dhe një vlerësim real dhe objektiv të nxënësve por edhe në përgjithësi të procesit mësimor.

**Selvetë Sholla, anëtare e kuvendit** –tha se informata e hartuar nga Drejtoria e Arsimit, është një informatë mjaft e kompletuar, megjithatë ajo lidhur me këtë dokument parashtrij disa vërejte që lidhen kryesisht me procesin mësimor duke shprehur se numri i mungesave sidomos në shkollat e mesme është mjaft i lartë, dhe kjo ndodh për shkakun se nuk merren masa ndëshkuese ndaj nxënësve. Tutej ajo pyeti se nxënësit prej klasës X deri në klasën XII të cilët janë me tri e më shumë nota të dobëta e të cilët realisht për këta nxënës i bie që këta duhet ta përsërisin vitin atëherë pyetja është se ku mbesin këta nxënës ku hyn ky grup i nxënësve me tri e më shumë nota të dobëta. Pastaj shtoi se në informatë është shkruar se gjatë gjysmëvjetorit të dytë të këtij viti shkollor janë bërë kontrole sistematike mjekësore të nxënësve nëpër shkolla nga mjeket e QKMF-së, e për këtë ajo ceku se kjo punë jashtëzakonisht e madhe është kryer duke ju falënderuar mjekëve që QKMF-së me në krye Dr. Safet Idrizin, në fund ajo i falënderoj të gjithë mjeket pjesëmarrës në vizitat sistematike mjekësore për nxënësit për punën e shkëlqyer që kanë bërë.

**Ermal Lahu, anëtar i kuvendit**–tha se Drejtoria e Arsimit duhet të shtoj edhe me tej angazhimin e saj në ngritjen e kapaciteteve teknike për punë praktike sidomos në shkollat profesionale, gjithashtu Drejtoria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Drejtorin e Arsimit kanë bërë një punë të shkëlqyeshme në realizimin e vizitave sistematike mjekësore në shkollat e komunës, dhe sidomos me realizimin e projektit “dhëmb të shëndosh fëmijë të lumtur”. Në fund ai kërkoi nga Drejtoria e Shëndetësisë që për mbledhjen e ardhshme të sjell një informatë me shkrim lidhur me realizimin e këtij projekti.

**Syzana Sylla, anëtare e kuvendit** – tha se informata në fjalë i plotëson kriteret e duhura, mirëpo ajo paraqiti vërejt lidhur me atë se në informatë nuk është cekur se në shkollën “Naim Frashri” ka paralele të parashkollorëve ,si dhe njoftoi se në informatë nuk është theksuar se këtë shkollë punohet me dy grupe.

## 5. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë ushqimore.

**Agim Bregaj, anëtar i kuvendit**– tha se objektivi themelor strategjik i Drejtorisë për Inspektime duhet të jetë shkalla më e lart e garantimit të shëndetit të qytetarëve dhe perfeksionizmi e sistemit mbikëqyrës për garantimin e sigurisë nga sëmundjet alimentare, dëmtimet si pasojë e produkteve ushqimore në përgjithësi duke përfshirë të gjitha llojet e ushqimit. Tutje shtoi se rëndësia e vendosjes së politikës dhe të ushqyerit si synim themelor i politikës së zhvillimit dhe objektivat strategjike ku si hallkë e vetme e zingjirit duhet të jetë shumë e fortë në rast se synohet ruajtja e plotë e shëndetit të konsumatorëve. Pastaj ai vlerësoi se DI-ja duhet të ketë në vëmendje forcimin e kontrollit dhe monitorimin e ushqimit që sillen në tregun tonë të destinuar për konsum njerëzor dhe për ushqimet që përdoren për njerëz dhe kafshë. Në vazhdim ai vlerësoi se Drejtoria për Inspektime duhet të punoj për objektiva dhe prioritetet afatgjata dhe afatmesme dhe për mënyrat e arritjes së tyre në drejtimet dhe detyrat funksionale të këtyre sektorëve, si në vijim 1.pjesëmarrje në hartimin e politikave në fushën e sigurisë ushqimore për zbatimin e strategjisë sektoriale si dhe në bazë të parimet nga ferma në tavolinë, 2. Hartimin e draft-strategjisë në fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtës së konsumatorit, 3.hartimin e programeve për përafrimin në fushën e sigurisë ushqimore afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë dhe ndjekjen e zbatimit të tij në periudha të caktuara 4. Zgjidhjen e ekspertëve në lami të caktuara sektoriale, 5. Licencimin e operatorëve të biznesit ushqimor si dhe inspektimin paraprak dhe ata që kanë aplikuar deri me tani. Në fund ai ftoj Drejtorin e Inspektimeve dhe Drejtorin e Shëndetësisë që të bashkëpunojnë ngushtë në marrjen

e masave dhe përgjegjësisë në ruajtën e shëndetit të qytetarëve ushqimin e tyre , kontrollimin e ujit dhe produktet ushqimore specifike.

**Selvetë Sholla, anëtare e kuvendit** –tha se informata e cila na është ofruar është mjaft e mangët, dhe atë pikësëpari askund në këtë informatë nuk është cekur pesha e produkteve të asgjësuarra si dhe kohëzgjatja për periudhën e asgjësimit askund nuk është cekur. Tutje pyeti se është numri dyqaneve të cilat nuk posedojnë arka fiskale ose që i kanë dhe nuk i përdorin apo i kanë por janë jashtë funksionit. Pastaj vazhdoi duke pyetur se drejtorja, a ka bërë inspektimin e depove e mallrave kur dihet mirë se aty bëhen më tepër manipulimet e ndryshme, si dhe pse në treg askund nuk figurojnë çmimet e produkteve të ndryshme por edhe në disa prej dyqaneve.

**Gëzim Saraqi, drejtor i Drejtorisë së Inspektiveve-paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me informatën në fjalë duke u përgjigjur në pyetjet e parashtruara nga anëtarët e kuvendit.**

## 6. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor i aktiviteteve Kulturore, Rinore dhe Sportive.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** –tha se në raportin e gjashtëmujorit të aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive vërejmë se sa i përket aktiviteteve sportive në raport është e paraqitur vetëm një tabelë e cila fletë për shfrytëzimin e palestrës sportive pa pagesë nga klubet sportive dhe individë. Pyetja që shtrojmë ne është se: Ku mbeti përkrahja aq shumë e premtuar për klubet sportive të qytetit nga kryetari i Komunës e deri te kandidatët për deputetë në Kuvendin e Kosovës gjatë fushatës së kaluar për zgjedhjet qendrore.

Klubet të cilave iu premtua përkrahje e madhe, sot janë në gjendje të mjerueshme. Të gjitha klubet e qytetit tonë, tani në prag të fillimit të sezonit të ri sportiv nuk e kanë të sigurt fillimin e garave për shkak të gjendjes së tyre të rëndë financiare. Klubi i futbollit “Kosova Vushtrri” tash ka probleme financiare, që për pasojë kanë sjellë largimin e futbollistëve kryesor nga ky klub. Është turp për udhëheqjen e qeverisjes lokale që ky klub që vitin e kaluar ishte kampion i Super ligës së Kosovës, tash vetëm një vit më pas rrezikohet prej rënies nga Super liga, dhe në rastin me të keq, nga shuarja totale e tij.

Hiq më mirë nuk qëndrojnë punët as në klubet e Hendbollit, Basketbollit dhe sporteve të tjera. Ftojme kryetarin e komunës që urgjentisht t’i përkrah në çfarëdo mënyre klubet e qytetit, sepse gjendja në sportin vushtrrias është alarmante.

Tek aktivitetet kulturore – teatrale flitet për provat e komedisë “Burri burrë”, premierën e kësaj komedie, pjesëmarrjen në Festivalin Tradicional të Komedisë në Mitrovicë të kësaj komedie etj.

Pyetja që shtrojmë ne është: a është përkrahur kjo shfaqje dhe sa mjete financiare u janë dhënë?. Këtë pyetje e shtrojmë për shkak se, kush ka pasur mundësi ta përcjellë shfaqjen, përveç aktrimit të mrekullueshëm të aktorëve që nuk mungoi, gjërat tjera përcjellëse si kostumografia dhe skenografia kanë munguar. Me siguri kjo ka ardhur si pasojë e mungesës së përkrahjes nga DKRS.

**Arta Ismajli, anëtare e kuvendit**-tha se në raportin gjashtëmujor të aktiviteteve të Drejtorisë për Kulture, Rini dhe Sport ne komunën tonë shihet se ka pas një mori aktiviteteve të cilat janë për tu përshëndetur ngase se kjo drejtori ka kryer edhe aktivitete të cilat janë të nivelit të përgjithshëm komunal në të gjitha ngjarjet dhe manifestimet komunale.

Tutje shtoi se do te duhej te keni në konsideratë edhe sugjerimet tona se kjo drejtori dhe sektorët e saj do te duhet me shume te orientoheshin ne hartimin e programeve kulturore dhe pa dyshim edhe aktiviteteve te cilat dalin nga ky program.

Konsideroj se me te gjithë këto aktivitete ka mungese te punës ne sektorët e kësaj drejtorie . Duke pas parasysh disa prej aktiviteteve si puna jo vetëm me asistencë teknike dhe organizative ne manifestimet e ndryshme por me shumën programe kulturo-artistike duke përfshire organizimin e koncerteve, përgatitjen e koreografive te reja, funksionaliteti i orkestrës në programe të ndryshme.

Po ashtu edhe teatri do të duhej të kishte tashmë ndonjë vepër artistike teatrale e cila është më kompletë dhe jo vetëm komedi te shkurtuara, teatri pasi edhe ka financim te veçantë deri më tani nuk e ka justifikuar veprimtarinë e vet.

Palestra sportive shihet se ka evidentuar vetëm terminët e aktiviteteve për rekreacion dhe konsideroj se aty do të duhej të ishte një menaxhim me i mire i këtij objekti për ofrimin e kushteve për zhvillimin e sporteve te ndryshme.

Kjo drejtori do të duhej që të punoj më shumë në programet rinore dhe po ashtu unë e konsideroj se nuk është e nevojshme që të përshkruhen edhe aktivitetet me OJQ-të pasi që nuk është pune ekskluzive e saj.

Në funde duke përshëndetur aktivitetet dhe raportin tha se shpreson në ndryshime në të ardhmen në avancimin e mëtutjeshëm të aktiviteteve kulturo-sportive.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit**-tha se informata të cilën e ka ofruar drejtori është një informatë e mirë, informatë e cila çdonjërit i ofron mundësi të dijë punët dhe aktivitetet që janë bërë në fushën e kulturës, sportit dhe në rini prandaj është shembull se si duhet bërë një informatë për të ardhmen edhe për drejtorit tjera komunale. Tutje shtoi se nëse dëshirojmë të avancojmë në fushën e kulturës duhet të kemi një angazhim të gjithmbarshëm si kuvend dhe si qeverisje lokale në përgjithësi. Pastaj ai vlerësoi se gjendja e muzeut të qytetit nuk është e mirë dhe kërkoi që kjo gjendje të ndryshohet duke u planifikuar mjete financiarë, për blerjen e eksponateve të cilat janë në shkatërrim e sipër, sepse nëse vazhdohet kështu atëherë do të detyrohemi ta mbyllim muzeun sepse nuk do të ketë kurrfarë eksponatesh. Mandej ai kërkoi nga drejtorja, që në arkivin historik të ofrohen kushte më të mira për punë duke angazhuar student me kontratë mbi veprën të cilët do të merren me arkivimin e këtyre dokumenteve.

**Zoran Rakiç, anëtar i kuvendit**- tha se në bazë të raportit shihet se ne nuk jemi duke i kushtuar vëmendjen e merituar kulturës në Vushtrri si qytetit më i vjetër i Kosovës. Pastaj ai i sugjeroi Drejtorisë së Kulturës që të krijoj kushte më të mira për zhvillimin e aktiviteteve kulturore nga të rinjtë e komunës sonë. Tutje ai njoftoi kuvendin se shtëpia e kulturës në fshatin Prelluzhë është vendi i vetëm kum mund të shfaqen aktivitetet kulturore, andaj kërkoi që kjo qendër të përkrahet financiarisht nga autoritetet komunale duke iu mundësuar pagesa apo mbulimi i borxhit që ka kjo qendër për shpenzimin e energjisë elektrike. Në fund ai pyeti lidhur me realizimin e një kërkesë të një kubi futbollistik nga fshati Prelluzhë për ofrimin e ndihmës për këtë klub.

**Melihate Basholli, anëtare e kuvendit**-tha se në bazë të raportit shihet puna e madhe që është bërë nga Drejtorja e Kulturës, si në aktivitetet kulturore ashtu edhe në ato sportive në përgjithësi. Tutje shtoi se shfrytëzimi pa pagesë i palestrës sportive është një mbështetje shtesë për sportin e komunës, dhe në të njëjtën kohë e përgëzoi drejtorin për mbajtjen dhe organizimin e bashkëpunimit me OJQ-të e ndryshme dhe me institucionet tjera. Në fund ajo kërkoi nga kryetari i komunës që përkrahet kultura në përgjithësi por në veçanti kërkoi vëmendje në financimin e veprimtarisë së Bibliotekës e Qytetit, (sidomos në financimin e librit shkollor me tituj të ri si lektura shkollore për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme).

**Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit** –pyeti lidhur me projektin e ndërtimit të shtëpisë së kulturës në fshatin Shtitaricë, pasi në shumë bashkësi lokale janë paraparë projektet të tilla për ndërtimin e këtyre qendrave.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** – tha se në të kaluarën kanë ekzistuar shumë shoqëri kulturo-artistike nëpër bashkës lokale dhe pikërisht nga këto shoqëri kanë dal shumë artist qoftë valltar apo edhe instrumentist të veglave të ndryshme muzikore, andaj në këtë kontekst ai kërkoi nga Drejtorja e Kulturës që të ftohen në një takim të gjitha këto shoqëri kulturore dhe që të paktën moralisht të përkrahen.

**Shpresa Rama, Drejtoresh e DKRS-së**- paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me raportin në fjalë duke u përgjigjur në pyetjet e parashtruara nga anëtarët e kuvendit.

**Qerim Selimi, anëtar i kuvendit** –paraqiti sqarim lidhur me objektin e shtëpisë së kulturës në fshatin Shtitaricë, dukuke njoftuar se me një vendim të kryetarit të komunës të gjitha



bibliotekat që janë nëpër shkolla të kalojnë në menaxhim të Drejtorisë Komunale të Arsimit për arsye të shumta e një ndër to ishte se këto shkolla edhe furnizimin me rrym edhe me nevoja tjera i kryejnë përmes shkollës dhe kështu bëhet një menaxhim më i mirë i këtyre qendrave duke menduar se kjo bibliotekë do të funksionoi më mirë në këtë kuadër, andaj një vendim i tillë është marr në vitin 2013 dhe ka mbetur që për vitin 2014 personeli i këtyre qendrave të planifikohet në vinë buxhetore të Drejtorisë së Arsimit. Në fund a tha se punëtori në bibliotekën në fshatin Shtitaricë dhe kjo qendër duhet të futet nënë autoritetin komunal përkatësisht nënë kompetenca e Drejtorisë së Arsimit.

**Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit** –tha se duhet të shikohet mundësia financiare që kjo Qendra e Kulturës në fshatin Shtitaricë të funksionalizohet dhe të futet në autoritetin e komunës.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** –shprehu shqetësimin e tij lidhur me mos ruajtjen e trashëgimisë kulturore, siç është qendra e kulturës në Shtitaricë por edhe dëmtimi i objekteve tjera kulturore siç është Shtëpia e “Mahmut Agë Gjinollit” ku është bërë renovimi i saj dhe tash përsëri po demolohet.

7. Shqyrtimi Propozim-Vendimit për shpërndarjen e mjeteve nga Fondi për Transfere dhe Subvencione.

**Arta Ismajli, anëtare e kuvendit**- vlerësoj se organizimi i panairit të shkencës dhe kulturës me siguri se është një ngjarje e rëndësishme, por a është mundur që kësi aktivitete të organizojnë edhe drejtoritë përkatëse si ajo e Arsimit dhe Kulturës.

Duke u nisur nga fakti se aktivitetet e tilla ndikojnë në edukim dhe në punët praktike ndoshta propozuesi do të duhej që për 1500.00 € të shpallte grant.

Me qëllim që konkurrenca të jete më e forte dhe ky aktivitetet ti përmbushë pritjet tona dhe me këtë të arrihet transparenca e duhur dhe jo vetëm OJQ “Lëvizja Koha” të ketë të drejtë ekskluzive për organizimin e këtij aktiviteti që prapë konsideroj se kësisoj më mire do të ishte që vetë drejtorit përkatëse të jenë organizatore për çka edhe kanë mandat, kompetencë dhe mjete të mjaftueshme.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit, me 20 vota “për”, tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:**

**1.Me këtë vendim, ndahet mjetet financiare në shumën prej një mijë e pesëqind euro (1.500€) për OJQ-në “Lëvizja Koha”, për aktivitetin tradicional “PANAIR I SHKENCËS DHE KULTURËS”, këto mjete ndahen nga buxheti i komunës –fondi për transfere dhe subvencione për vitin 2015.**

**2.Mjetet në shumën e cekur si në pikën 1 të këtij vendimi ndahen në bazë të kritereve dhe kushteve të përcaktuara me Rregulloren për përcaktimin e kritereve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondit për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale entiteteve publike dhe jopublike 01Nr.37-2/11, datës 24.02.2011, si dhe pas dorëzimit të raportit nga përfituesit e këtij fondi për shfrytëzimin e mjeteve nga viti 2014.**

**3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.**

8. Shqyrtimi i Draft-Planit të veprimit për rini.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

1. Jepet në diskutim publik Draft-Plani Lokal i Veprimit për Rini.
  2. Diskutimi publik fillon nga data 05 gusht 2015 dhe zgjatë deri më 19 gusht 2015.
  3. Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.
  4. Obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport që si hartues dhe propozues i Draft-Planit në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 05/2013, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.
  - Gjithashtu DKRS-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Planit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin shtator 2015.
  9. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për promovimin dhe fuqizimin e vullnetarizmit të të rinjve dhe pjesëmarrjen e rinisë.
- Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:
- Aprovohet Rregullorja për promovimin dhe fuqizimin e vullnetarizmit të të rinjve dhe pjesëmarrjen e rinisë, me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga anëtarët e kuvendit.
10. Shqyrtimi i Draft-Planit pesëvjeçarë për menaxhimin e mbeturinave për periudhën 2016-2020 në Komunën e Vushtrrisë.

**Islam Latifi, zyrtar i DSHP-së**-paraqiti sqarime hyrëse për këtë pikë të rendit të ditës, në cilësinë e sponsorizuesit të këtij dokumenti komunal.

**Fatime Haziri, anëtare e kuvendit** –në emër të grupit kuvendar të LDK-së, kërkoi sqarime për fatin e punëtorëve të kompanisë “Uniteti” dhe pyeti se këta punëtor si do të sistemohen në operatorin e ri ekonomik i cili do të merret me këtë çështje dhe se 50 punëtorët e kësaj kompanie a mos vallë do të mbesin pa punë, dhe familjet e tyre do të kërkojnë ndihmë sociale.

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit** –pasi përgëzoi drejtorin për hartimin e këtij draft-plani, dhe shtoi se edhe ekzekutivi por edhe kuvendi duhet të trajtoj me prioritet të lartë çështje e menaxhimit të mbeturinave, duke pasur parasysh gjendjen e mbeturinave në komunën tonë. Tutje ai ceku se një nga shkaktaret e paraqitjes së sëmundjeve epidemike siç është tularemija të cilat ishin mjaft prezentë në këtë fillim vit në komunë tonë janë pasoj i menaxhimit jo të mirë të mbeturinave. Pastaj ai tha se sa i përket anës ligjore të kësaj rregulloreje kjo është filtruar edhe nga zyra ligjore andaj e njëjta është në pajtueshmëri me ligjin andaj të njëjtën kërkoj që kuvendi ta aprovoi. Mandej ai shtroj si çështje brengosëse çështjen e punëtorëve të kompanisë “Uniteti” pasi edhe kushtet e punës por edhe gjendja shëndetësore e këtyre punëtorëve nuk është e mirë, andaj kërkoi që për këta punëtor të krijohen kushte më të mira të punës si dhe kërkoj që në rast të ndryshimeve ligjore lidhur me menaxhimin e mbeturinave të sigurohen kusht që këta punëtor të mos mbesin pa punë. Në fund ai tha se pasi që gjendemi në fazën e planifikimit të buxhetit kishte me qenë mirë që të parashihej edhe kostoja financiare e këtij draft-plani.

**Zoran Rakiç, anëtar i kuvendit**-tha se është mirë që komuna ka marr iniciativën për hartimin e këtij draft-plani pasi që gjendja e menaxhimit me mbeturina në krejt territorin e komunës

është e rëndë. Tutja ai shprehu pakënaqësinë e tij për punën e kompanisë “Uniteti” e cila nuk e ka kryer punën si duhet, por në anë tjetër bashkëfaktorë për këtë jemi të gjithë ne që nuk po paguajmë obligimet me rregull me kohë. Pastaj vlerësoi se të gjithë ne por edhe deputet mbajnë përgjegjësi për këto mos pagesa dhe në përgjithësi për infrastrukturën komunale. Në vazhdim ai shprehu nevojën që të krijohet një kompani e re për menaxhimin e mbeturinave e cila do të punonte në pajtueshmëri me rregullat në fuqi. Gjithashtu ai paraqiti vërejtje në këtë draft-plan lidhur me numrin e banorëve të fshatit Prelluzhë, duke aluduar se numri i banorëve në këtë fshatë është më i madh se sa ai që është paraqitur në këtë dokument. Në fund ai pyeti lidhur me atë se Zyra Lokale e Komuniteteve në Prelluzhë ka marrë dy traktor për zhvillimin e aktiviteteve të tyre, dhe njoftoi se ata traktorë janë uzurpuar nga persona privat ata traktorë kanë qenë të pajisur me rimorkio dhe me cisternë andaj lidhur me këtë çështje kërkoi që këto asete të kthehen në pronësi të komunës me qëllim që të përdoren për aktivitetet e fshatit Prelluzhë.

**Dibran Perçuku, nënkryetar i komunës**-pasi përgëzoi Drejtorin e Shërbimeve Publike për hartimin e draft-planit për menaxhimin e mbeturinave, shtoi se ky planë është një bazë e mirë për krijimin e atmosferës së mirë për investime të huaja në fushën e menaxhimit të mbeturinave. Tutje ai sqaroi se komisioni komunal i cili është marrë me hartimin e këtij dokumenti është shërbyer me literaturë ligjore dhe profesionale, si dhe janë marrë përvojat dhe plani i Komunës së Prizrenit si mostër. Tutje shtoi se në bazë të këtij plani parashihet që komuna të ndahet në tri zona një zonë në qytet, kurse dy zona tjera në fshatrat e komunës. Pastaj lidhur me shqetësimin për punëtorët e kompanisë “Uniteti” ceku se ata punëtor do të qëndrojnë në kompani dhe nuk do t’iu ndërpritet marrëdhënia e punës, kurse dy kompanitë tjera do të jenë kompani të reja që do ta shtrijnë veprimtarin në 66 fshatrat e komunës. Pastaj ai duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit lidhur me numrin e banorëve të fshatit Prelluzhë ceku se këto të dhëna lidhur me banorët janë marrë në bazë të regjistrimit zyrtarë të popullatës në vitin 2011. Në fund ai apeloj tek Drejtoria e Shërbimeve Publike që dy traktorët e uzurpuar nga ana e qytetarëve të merren në pronësi të komunës.

**Fatime Haziri, anëtare e kuvendit** –tha se grupi kuvendar i LDK-së do votoj pro këtij draft-planit, por do të kërkoj përgjegjësi të vazhdueshme nga autoritetet komunale lidhur me fatin e punëtorëve të Kompanisë “Uniteti”.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

**1.Jepet në diskutim publik Draft-Plani Pesë-Vjeçar i Menaxhimit të Mbeturinave për Komunën e Vushtrrisë 2016-2020.**

**2.Diskutimi publik fillon nga data 05 gusht 2015 dhe zgjatë deri më 19 gusht 2015.**

**3.Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.**

**4.Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike që si hartues dhe propozues i Draft-Planit në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 05/2013, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.**

**Gjithashtu DSHP-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t’ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Planit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin shtator 2015.**

11. Shqyrtimi i petitionit të banorëve të fshatit Gllavatin lidhur me kundërshtimin e vendimit të KK-së 01 Nr.70/14 të datës 27.03.2014.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** –tha se trajtimi i këtij peticioni është obligim ligjor dhe ne për të dëshmuar se jemi në shërbim të qytetarëve duhet ta shqyrtojmë këtë peticion, andaj për këtë çështje ai propozoi që të formohet një komision mikst nga kuvendi dhe ekzekutivi komunal gjegjësisht nga Drejtoria e Urbanizimit dhe Drejtoria e Kadastrit, komision i cili do të konstatoj gjendjen reale dhe të del me një propozim se çka duhet të vepohet më tutje duhet të gjendet ndonjë lokacion i ri për varreza apo duhet të mbetet në fuqi vendimi i cili është aprovuar nga ana e kuvendit të komunës.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** –tha se kuvendi i komunës nuk duhet të marr vendime të shpejta, pa i analizuar mirë dhe pa e ditur gjendjen faktike mirë. Tutje shtoi se edhe atëherë kur është marrë ky vendim kishte thënë së është vendim i pa analizuar mirë dhe pa ditur se kujt i takon ajo pronë dhe kujë i ka takuar në të kaluarën për faktin se në vendin tonë vinë në funksion disa zakone dhe tradita për të cilat duhet të bëhen analiza të duhura. Andaj ai e mbështeti propozimin që të formohet një komision i cili do të mërej me konstatimin e gjendjes faktike lidhur me këtë pronë.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** –tha se është i drejt mendimi që të formohet ky komision për vlerësimin e gjendjes faktike para se të merret një vendim lidhur me këtë çështje andaj për anëtar të komisionit propozoi Qerim Selimin.

**Fatime Haziri, anëtare e kuvendit**-propozoi Shkelzen Feken për anëtar të komisionit.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – propozoi Ali Januazin për anëtar të komisionit.

**Dibran Perçuku, nënkryetar i komunës**-propozoi për anëtar të komisionit Bedri Dobren, dhe Rushit Bilallin nga ekzekutivi komunal.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

**1.Me këtë vendim formohet komisionin komunal, për konstatimin e gjendjes faktike, të pronës komunale të destinuar për vendosjen e varrezave të fshatit Stroc, e cila është ndarë nga ana e Kuvendit të Komunës në bazë të vendimit 01.Nr.70/14 të datës 27.03.2014 në këtë përbërje:**

**1.1 Qerim Selim, anëtarë i kuvendit;**

**1.2 Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit;**

**1.3 Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit;**

**1.4 Bedri Dobra, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe**

**1.5 Rushit Bilalli, nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.**

**2.Banoret e fshatit Gllavatin me anë të petitionit të parashtruar me datën 06.07.2015 e kanë kundërshtuar vendimin e Kuvendit të Komunës 01.Nr.70/14 të datës 27.03.2014, lidhur me caktimin e lokacionit të varrezave të fshatit Stroc, andaj komisioni në fjalë do të ketë për detyrë të konstatoj saktë dhe drejt gjendje faktike, dhe ti propozoi kuvendit një zgjidhje të përshtatshme.**

**3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni cekur në pikën 1 të këtij vendimi.**

12. Shqyrtimi i petitionit të autokombajnerëve të Komunës së Vushtrrisë.

**Arta Haxhaj, drejtoresh e DEBZHR-së**-paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke shtuar se peticioni në fjalë i është drejtuar kryetarit të komunës dhe kuvendit, ku është adresuar problemi i këtyre autokombajnerëve të komunës sonë me ata të komunave tjera të cilës kanë zhvilluar veprimtarin e tyre në territorin e komunës sonë. Në vazhdim ajo sqaroi se drejtorja iu është drejtuar me shkrim Komisionit për Korrje Shirje në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë po akoma nuk kemi asgjë me shkrimin si si të veprohet pas krijimit të kësaj gjendje.

**Qerim Selimi, anëtar i kuvendit** –tha se çështja e këtij peticioni mund të cilësohet si çështje me interes për autokombanjerët por nuk mund të thuhet se është interes për qytetarët. Pastaj ai argumentoi se çështja e korrje-shirjeve dhe përzgjedhjes së autokombajnerëve është çështje autonome dhe e konkurrencës së lirë të cilën vet qytetarët e zgjidhin dhe kjo nuk mund ti nënshtrohet kufizimeve me vendime administrative apo politike të nxjerra nga organet komunale. Në fund ai tha se ajo çka i takon kuvendit e veçanërisht komisionit për korrje-shirje si dhe Drejtorisë së Inspektimeve është çështja e cilësisë së kombajnave dhe gjendja teknike e tyre si dhe cilësia e ushtrimit të kësaj veprimtarie.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** –vlerësoi dhe konkludoi se pasi që kuvendi i komunës, nuk ka të drejtë që të kufizoj veprimtarit ekomomike ligjore dhe të lira, i rekomandoj Drejtorisë së Bujqësisë që në ardhmen të vlerësoi anën ligjore dhe të ofroj para kuvendit një propozim-vendim apo një propozim-rregullore me të cilën do të rregullohej kjo çështje.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

**Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me datë 30 korrik 2015, pas shqyrtimit të peticionit të autokombajnerëve të Komunës së Vushtrrisë, iu**

#### **Njofton**

**Se ka aprovuar rekomandimin që Drejtorja për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në kuadër të kompetencave ligjore të saj të ofron para kuvendit një propozim-vendim apo një propozim-rregullore me të cilin do të rregullohej çështja e ushtrimit të veprimtarisë së korrje-shirjeve nga ana e autokombajnerëve nga komunat tjera të Kosovës në Komunën e Vushtrrisë.**

**13. Të ndryshme.**

**14. a). Shqyrtimi i Draft-rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunës e Vushtrrisë.**

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

**1.Jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.**

**2.Diskutimi publik fillon nga data 05 gusht 2015 dhe zgjatë deri më 19 gusht 2015.**

**3.Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.**

4. Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike që si hartues dhe propozues i Draft-Rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 05/2013, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Gjithashtu DSHP-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin shtator 2015.

14. b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për shërim për Xhavit Hysenin.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** –tha se pasi që në propozim-vendim nuk është cekur shuma e mjeteve financiare për ofrimin e ndihmës për shërim për Xhavit Hysenin, atëherë ai propozoi që kjo shumë të jetë në vlerë prej 2000€.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

1.Me këtë Vendim lejohen mjete financiare në vlerë prej dy mijë euro (2000 €) nga buxheti i komunës – programi zyra e Kryetarit nga kategoria “subvencione dhe transfere” për Xhavit Hysenin me banim në, Vushtrri Rr. “Faik Konica”.

2.Shuma e cekur në pikën 1 të këtij Vendimi ndahet me qëllim të shërimit të sëmundjes së tij.

3.Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

14. c). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit**–kërkoj informatë me shkrim, lidhur rregullimin e rrugës në fshatin Stroc, e cila është dëmtuar me rastin e vërshimeve.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** –kërkoj informatë me shkrim, lidhur me atë se përse komuna po bënë investime në objektet e KEDS-it, sa është shuma e këtyre mjeteve financiare dhe ku janë bërë këto investime. Pastaj kërkoj informatë zyrtare lidhur me afatin e lëshimit në funksion të fabrikës së ujit. Si dhe kërkoj përgjigje me shkrim lidhur me përfundimin e projektit të ndërtimit të objektit të ri të komunës. Në fund ai tha se si kuvend po sillemi me papërgjegjësi, lidhur me çështje e mbulimit të shpenzimeve të varrimit nga ana e komunës, andaj ai kërkoj nga ekzekutivi por edhe nga kuvendi që të bëjë një zgjidhje në këtë drejtim duke marr një vendim lidhur me këtë çështje.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** – pyeti se përse komuna gjegjësisht DSHP-ja, nuk merret me mirëmbajtjen (ujitjen) e drunjtëve dekorativ në rr. “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, si dhe përse kjo drejtori nuk ndërmer masa për mirëmbajtjen (ujitjen e drunjtëve dhe barit) të lokacionit ku është i vendosur lapidari i dëshmorëve tek ish stacioni i vjetër i autobusëve.

**Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit** –kërkoj sqarime nga komisioni kuvendar i formuar muajin e kaluar lidhur me takimet që ka zhvilluar me ministrin përkatëse për çështje e stacionit të autobusëve, nënkalinin dhe kyçjen në fshatin Lumëmadh. Pastaj kërkoj nga Drejtoria për Bujqësi, që ti ofrojë kontratën e dhënies në shfrytëzim të pronës së komunale shfrytëzuesit Musa Cakaj nga fshati Lummadh, duke dhënë arsyetimin se a janë respektuar kriteret për dhënien në shfrytëzim të kësaj prone, si dhe shfrytëzuesi a ju ka përmbajtur kontratës lidhur me destinimin e shfrytëzimit të kësaj prone. Në fund ai duke ju referuar informatës së ofruar nga

Drejtoria e Inspektiveve për ekzekutimin e vendimeve për rrënimin e objekteve pa leje, tha se kjo informatë nga ana teorike është shumë e mirë por në praktik del se asgjë nuk është punuar në zbatimin e këtyre vendimeve, dhe nga kjo shihet se nuk ka vullnet dhe guxim nga politika zyrtare komunale për të kryer punët dhe përmbushur detyrat e parapara me ligj.

**Syzana Sylja, anëtare e kuvendit** –parashtror një kërkesë të banorëve të fshatit Mihaliq, konkretisht në pronën e Beqir Syles kalojnë ujërat e zeza, ku kemi një kundërmim të jashtëzakonshëm të erës dhe ka rrezik potencial të përhapjes të ndonjë epidemie, andaj edhe pusët e ujit nuk mund të përdoren për pije dhe për pastrim këtë gjendje e ka konstatuar Enti Higjenik në Mitrovicë. Tutje njoftoi se pronari i kësaj shtëpi i në kushte të vështira ekonomike i ka blerë dhjetë gypa uji F-1000, dhe i njëjti ka kërkuar nga DSHP-ja që të bëhet një zgjidhje me këta gypa mirëpo përgjigja ka qenë se drejtoria nuk ka mjetet për realizimin e kësaj kërkesë. Kërkoj nga DSHP-ja që ky qytetar të furnizohet me gypa për ujërat e zeza, si dhe në të njëjtën kohë kërkoj nga kjo drejtori që ti ofrohet një informatë/raport për periudhën janar-qershor 2015 se për cilët qytetar është bërë furnizimi me këta gypa, kush ka qenë në komision për këtë çështje dhe me çfarë kriteresh është bërë shpërndarja e këtyre gypave. Në fund ajo kërkoj që për vitet e ardhshme të formohet një komision i cili do të merrej me këtë çështje, dhe të kemi transparencë në ndarjen dhe shpërndarjen e këtyre gypave.

**Zoran Rakiç, anëtar i kuvendit**–paraqiti shqetësimin e tij lidhur me një aksion të ndërmarr nga kompania KEDS për zhvendosjen e njësorëve elektrik nga shtëpitë në shtylla elektrike në fshatin Prelluzhë. Tutje ai kërkoj që zhvendosja e këtyre njësorëve mos të bëhet pa u bërë ndërrimi i shtyllave të drurit në shtylla elektrike të betonit.

**Fakete Dushi, anëtare e kuvendit** –paraqiti një shqetësim dhe kërkesë të banorëve të fshatit Novoln për shtrimin e një rruge në asfalt afër fabrikës së miellit “Molitoria” rrugë e cila ka një gjatësi nga 500-600m, andaj kërkoj që kjo kërkesë të realizohet.

**Ergyn Sunguri, anëtar i kuvendit** –kërkoj që në zyrën lokale të angazhohet ndonjë pjesëtarë i komunitetit turk, dhe kërkoj që dokumentet që lëshohen nga komuna të lëshohen edhe në gjuhën turke.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** –ngriti shqetësimin e tij lidhur me zvogëlimin e numrit të policëve në patrulla, andaj kërkoj nga kryetari i komunës që të realizoi një takim me zyrtarët e policisë për rritjen e numrit të policëve dhe rritjen e numrit të patrullave.


**Mbledhja përfundoi në orën 12:30.**

**Bastri Duraku**



**Procesmbajtës**

**Shpëtim Zhegrova**



**Kryesues i Kuvendit**

